

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	26.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **24.05.2021**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME**, me Numër të prokurimit: **623-21-1546-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-009-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME**, me Numër të prokurimit: **623-21-1546-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-009-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **19.05.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. **ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME**, me Numër të prokurimit: **623-21-1546-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-009-5-2-1**, dhe i njëjti aktivitet i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME**, me Numër të prokurimit: **623-21-1546-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-009-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **19.05.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **24.05.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore të kërkesës

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

1. Ju njoftojmë se sqarimin e kerkuar nga ju neve na keni kerkuar në bazë të pozicionit e Betonit me nr 3.1 3.2 3.3 dhe 3.4. Ku nga ne keni marrur përgjigje të bashkangjitura në sistemin e prokurimit me datën që keni kërkuar ju 11.05.2021 , ju kemi bashkangjitur sqarimet për këto pozicionet e betonit që janë të cekura më lartë. Ne si operator ekonomik ju kemi dhene sqarimet shumë të sakta dhe bindëse duke mos pasur asnjë problem në implementimin e projektit, ngase ne si Operator Ekonomik kemi shfaqur tek ju Stoqet tona me sasi të betonit dhe markës që keni kërkuar në paramasë, ku bashkangjitur kemi cekur se ju bashkangjesim edhe a-testet e betonit dhe cmimit te ofruar nga ne për 1m3 kemi ofruar 43Euro në këtë projekt, ku ne si kompani kemi ofruar te ju ne sqarim nje leter mbeshtetje te bashkangjitur nga një firmë e cila kemi marreveshje bashkpunimi per furnizim me beton dhe bashkangjitur kemi nje leter mbeshtetje nga ajo kompani qe na furnizon me Beton të markës së kërkuar në paramasë bashkangjitur me të gjitha a-testet, andaj në këto pozicione nuk do të kishte asnjë problem për implementim të këtij projekti.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që është absurde që të bëhet realizimi i kontratës për pozicione ku diferenca ne çmim duke llogaritur mesataren e të gjitha ofertave të përgjegjshme të pranuar dhe ofertës tuaj është nga 126 % deri në 210 % diferenca me çmimin e tregut:

PARAMASA DHE PARALLOGARIA NDËRTIMI I AMF-SE NË LAGJEN E EPËRME - RAHOVEC						Construmax	EBK SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik KUOTA SH.P.K.; DAR ING SH.P.K.; „ ENGRUP SH.P.K.; Bashkimi Projekt SH.P.K.	"NBT -ING" SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik AGE group SH.P.K.; SINANI ING SH.P.K.	Mesatarja	Perqindja %
3	PUNËT E BETONIT					EURO ING Sh.p.k.						
Poz.	Pershkrimi i Pozicionit	Njesia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH-ja 18%	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)		
3.1	Furnizimi dhe betonimi i shtresës së betonit, me beton të ngjeshur C15 Mpa ne trashësi d = 4-6 cm nen themele dhe plakë. E cila shërben si shtresë mbrojtëse e armatues dhe hidroizolimit.	m²	18.50	35.00	6.30	41.30	60.00	35.40	50.00	44.84	41.92	210%
3.2	Furnizimi dhe betonimi i themeleve shiritore, coldles dhe plakës së dyshemes dhe kulmit. Me beton te armuar C25- 30 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e jashtme e pahive te jete e lenuar.	m²	208.10	45.00	8.10	53.10	60.00	47.20	62.00	60.18	54.25	126%
3.3	Latimi dhe betonimi i trajeve me beton te armuar C25/30 Mpa	m²	32.00	45.00	8.10	53.10	60.00	59.00	52.00	60.18	54.55	127%
3.4	Latimi dhe betonimi i shtyllave me beton të armuar C25/30 në kallupet përkatëse sipas projektit.	m²	11.40	45.00	8.10	53.10	60.00	59.00	52.00	62.72	54.97	128%

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

2.Ju njoftojmë se sqarimin e kerkuar nga ju neve na keni kerkuar në bazë të pozicionit e armaturës 4.1. Ku nga ne keni marrurr pergjigje te bashkangjitura ne sistemin e prokurimit me datën që keni kërkuar 11.05.2021 , ju kemi bashkangjitur sqarimet për keto poziconet e armaturës që janë të cekura më lartë. Ne si operator ekonomik ju kemi dhene sqarimet shumë të sakta dhe bindëse duke mos pasur asnjë problem në implementimin e projektit, ngase ne si Operator Ekonomik kemi shfaqur tek ju Stoqet tona me sasi të armaturës, ku bashkangjitur kemi cekur se ju bashkangjesim edhe Pro Faturë nga një kompani e cila neve na furnizon me cmimin qe kemi ofruar në ofertë për 1kg kemi ofruar 0.39cent.Andaj ju kemi premtuar dhe ju kemi dhene sqarime bindëse që ky projekt do të përfundohet pa asnjë problem me te vogel.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që është absurde që të bëhet realizimi i kontratës për pozicione ku diferenca ne çmim duke llogaritur mesataren e të gjitha ofertave të përgjegjshme të pranuar dhe ofertës tuaj është 166 %, diferenca me çmimin e tregut:

PARAMASA DHE PARALLOGARIA NDËRTIMI I AMF-SË NË LAGJEN E EPËRME - RAHOVEC							Construmax	EBK SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik KUOTA SH.P.K.; DAR ING SH.P.K.; „ ENGRUP SH.P.K.; Bashkimi Projekt SH.P.K.	"NBT -ING" SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik AGE group SH.P.K.; SINANI ING SH.P.K.	Mesatarja	Përqindja %
4	PUNËT E ARMATURES			EURO ING Sh.p.k.									
Poz.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH-ja 18%	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)		
4.1	Blerja, transporti, prerja si dhe vendosja e ARMATURES ÇBR-400/500 Mpa në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike.	kg	26,756.80	0.50	0.09	0.59	0.60	0.83	0.83	0.65	0.39	0.65	166%

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

3. Ju njoftojmë se ne sqarimin e kërkuar ju kemi dërguar ne sqarim me datë 11.05.2021 që në vitin e kaluar është implementuar po një projekt i ngjashëm nga kompania jonë me cmime të betonit për 1m³ 43 Euro dhe ku ju vet si Autoritet Kontraktues jeni duke rënë në kundërshtim me veten ngase, në sqarimin e dhënë ju kemi treguar edhe Raportin e Pranimit të punimeve dhe situacionit të fundit për pagesë ku ky projekt është paguar nga ju me cmimet e Betanti për 43euro për 1m³ dhe cmimi i armaturës 0.39 për 1kg që ishte i ofertuar nga kompania jonë dhe i pranuar nga ju si Autoritet Kontraktues , kështu ju kam bashkangjitur në fund të sqarimit që edhe kjo të ju vertetoj se ne si kompani kemi përfunduar dhe ju kemi thënë se do t'ia përfundojmë shumë saktë sipas selicit pozicion të përshkruar dhe pa asnjë problem më të vogël në implementimin e projektit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që bazuar në pretendimet e lartë përmendura 1 dhe 2, si dhe duke u bazuar se kjo është oferta e vitit 2019 dhe se çmimet në treg vazhdimisht kanë pasuar rritje.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

4. Ju si Autoritet Kontraktues nuk keni zbatuar Neni 7 i LPP - se - Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Për arsye ngase ju si Autoritet Kontraktues keni kërkuar vetem nga ne sqarime për pozicionet e tenderit me cmime jo-normalisht të ulëta.

Më datë 20.05.2021 ju kemi bere kerkese per dokumentacionet të Operatorit Ekonomik të shpallur fitues nga ju.

Më datë 20.05.2021 në ora 14:29 Masdite jeni pergjigjur dhe keni kërkuar qe nga data 21.05.2021 te tërhiqen dokumentacionet e kerkuara.

Më datë 21.05.2021 kam terhequr dokumentacionet e Operatorit Ekonomik të shpallur fitues nga ju , dhe kam vërejtur se keni shkelur Neni 7 i LPP - se - Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi , ngase Operatori Ekonomik nuk keni kërkuar sqarime shtesë për disa nga pozionet me cmime jo-normalisht të ulëta që nuk egzistojn fare as në treg. Si ku bashkangjitur keni pozicionet e Operatorit Ekonomik të shpallur fitues nga ju disa prej pozicioneve të bashkangjitura më poshtë:

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është pjesërisht i bazuar, pasi që për disa pozicione nuk janë kërkuar sqarime për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit